



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BRENDSHME

AGJENCIA SHTETËRORE E PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2022

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË  
MARRËVESHJEN KUADËR**

**(PAS PROCESIT TË ANKIMIT<sup>1</sup>)**

Datë: 05.10.2022

Drejtuar: **“REJ” SHPK**

*Adresa: “Zogu Zi”, Qatar - Center, kati 2, Tiranë.*

\* \* \*

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”- Marrëveshje kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me objekt: **“Shërbim pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës”**, me fond të marrëveshjes kuadër: 137,991,275 (njëqind e tridhjetë e shtatë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e një mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë) Lekë (pa TVSH), me numër reference: REF- 19625-02-14-2022.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike 21.02.2022, Nr. 23.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

- |                                                                                                                                                                 |                        |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|
| <b>1) BOE“METEO SHPK” SHPK</b>                                                                                                                                  | L26310801C             |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i>                                                                                                                                 | <i>numri i NIPT-it</i> |
| <b>“PASTRIME SILVIO” SHPK” SHPK</b>                                                                                                                             | K91413010N             |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i>                                                                                                                                 | <i>numri i NIPT-it</i> |
| Vlera: <b>106,899,711.43</b> (njëqind e gjashtë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë pikë dyzetë e tre) lekë (pa TVSH) |                        |
| <b>2) “ALKO-IMPEX General Construcion”</b>                                                                                                                      | K91326028I             |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i>                                                                                                                                 | <i>numri i NIPT-it</i> |
| Vlera: <b>121,432,903.81</b> (njëqind e njezet e një milion e katerqind e tridhjetë e dy mijë e nenteqind e tre leke, pikë tetëdhjetë e një) leke (pa TVSH);    |                        |
| <b>3) “CLEAN FAST” SHPK</b>                                                                                                                                     | L61807037R             |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i>                                                                                                                                 | <i>numri i NIPT-it</i> |

<sup>1</sup> Ky Formulari është i aplikueshëm nëse ka ankime

Vlera: **120,053,102.18** (njqind e njet milion e pesdhjetë e tre mijë e njqind e dy pikë tetëmbdhjetë) leke (pa TVSH)

4) **“REJ” SHPK**

*Emri i plotë i shoqërisë*

J93711608Q

*numri i NIPT-it*

Vlera: **113,365,021.65** (njqind e trembdhjetë million e treqind e gjashtdhjetë e pesë mijë e njetë e një, pikë gjashtdhjetë e pesë) leke (pa TVSH)

5) **“SORI-AL” SHPK**

*Emri i plotë i shoqërisë*

K31510059D

*numri i NIPT-it*

Vlera: **136,612,710.76** (njqind e trembdhjetë million e treqind e gjashtdhjetë e pesë mijë e njetë e një, pikë gjashtdhjetë e pesë), (pa TVSH).

**Për këtë procedurë prokurimi janë skualifikuar operatorët ekonomikë si vijon:**

**1) Arsyja e skualifikimit per BOE “METEO & PASTRIME SILVIO” SHPK**

- Ofertuesi nuk përmbush pikën 1, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE rezulton se, anëtari i Bashkimit të Operatorëve ekonomikë METEO SH.P.K.(**i cili në akt-marrëveshje rezulton me 51% të pjesmarrjes në shërbim**) nuk ka paraqitur asnjë përvojë të ngjashme, në kundërshtim me Nenin 88 pika 3 të VKM Nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se:“*Seicili prej antarëve të bashkimit, duhet të përmbushë kërkesat teknike në përputhje me përqindjen e përqindjen e pjesmarrjes në shërbim, të përcaktuara në akt-marrëveshje*”. Bazuar në shtojcën 8 të DST, “*Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false, konsiderohen kushte për skualifikim*”.

**2) Arsyja e skualifikimit për “CLEAN FAST” SHPK.**

- Ofertuesi nuk përmbush pikën 2, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim, në lidhje me profilet e detyrueshme të stafit kryesor, dhe konkretisht për funksionin “përgjegjës për zbatimin e kontratës në profilin inxhinier kimist/ose mjedisi”. Nga “Deklarata për përcaktimin e personit përgjegjës”, e paraqitur në SPE nga ofertuesi nuk rezulton që specialistja e deklaruar si përgjegjëse për zbatimin e kontratës, Znj. R.M., të jetë diplomuar në profilin inxhinier kimist/inxhinier mjedisi sic kërkohet në pikën 2, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim. Referuar dokumentacionit të paraqitur në SPE nga ofertuesi, rezulton se Znj. R.M., është diplomuar në profilin inxhinier ndërtimi (profili transport) dhe jo inxhinier kimist/inxhinier mjedisi.

**3) Arsyet e skualifikimit për “ALIKO IMPEX General Construction” SHPK.**

- Ofertuesi nuk përmbush pikën 2, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se për punonjësit e deklaruar “sanitare” nuk ka kontrata individuale të punës, por është paraqitur një kontratë kolektive e nënshkruar ndërmjet “Aliko Impex General Construction” në ciësinë e palës punëdhënëse, dhe nga 42 (dyzet e dy) persona në cilësinë e palës punëmarrëse, cka vjen në kundërshtim me parashikimet e nenit 160 të Kodit të Punës, sipas të cilit: “*Kontrata kolektive e punës lidhet nga një ose disa punëdhënës ose organizata punëdhënësish nga njëra anë dhe një ose disa sindikata nga ana tjetër*”. Në bazë të Nenit 76 pika 3 të LPP “*Cdo operator ekonomik s’kualifikohet nga pjesëmarrja nëse AK provon se ka shkelle ne detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, etj*”.
- Ofertuesi nuk përmbush piken 3/2, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim, pasi nuk disponon Vinc me kosh për larjen e dritareve ne lartesi. Nga

dokumentacioni i paraqitur në SPE, fotografi e Automjetit me targë AA586MS, rezulton se, ky i fundit nuk është sipas kërkesave të AK, Vinc me kosh për larjen e dritareve në lartësi.

- Ofertuesi nuk përmbush pikën 1, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se shërbimet e mëparëshme, të kryera gjatë 3 viteve të fundit, nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit. Furnizimet e mëparëshme të paraqitura në SPE nga ofertuesi, kanë si objekt pastrimin e rrugëve, grumbullimin dhe transportin e mbetjeve për qytetet Shkoder, Kavajë, Tiranë si dhe shërbime të tjera mirëmbajtje, të cilat nuk përbëjnë përvoja të mëparëshme të ngjashme me objektin e prokurimit (shërbim pastrimi i ambjenteve të brendshme dhe të jashtme të godinës).

#### 4) Arsyet e skualifikimit për “SORI-AL” SHPK.

- Ofertuesi nuk përmbush pikën 2, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim, në lidhje me profilet e detyrueshme të stafit kryesor, dhe konkretisht për funksionin “përgjegjës për zbatimin e kontratës në profilin inxhiner kimist/ose mjedisi”. Ofertuesi ka deklaruar (Deklarata për personelin e nevojshëm) për funksionin “Përgjegjës”, punonjësit A.B. dhe A.M, të cilët, referuar dokumentacionit të paraqitur në SPE, nuk rezultojnë të jenë diplomuar në profilin inxhiner kimist/inxhiner mjedisi, sic kërkohet në pikën 2, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim. Konkretisht, punonjësi A.B., është diplomuar në profilin “Agronomi e përgjithshme”, ndërsa punonjësi A.M., është i diplomuar në profilin “Inxhinieri Agromjedisi”.
- Ofertuesi nuk përmbush pikën 2, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim, pasi nga Deklarata për personelin e nevojshëm e paraqitur në SPE, rezulton se operatori ekonomik nuk ka të punësuar 42 sanitarë, por vetëm 26. Pjesa tjetër e punonjësve janë deklaruar si punonjës pastrimi, punonjës pastrimi të rrugëve dhe lulishteve.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “**REJ**” SHPK, me numër J93711608Q, me adresë: “Zogu Zi”, Qatar - Center, kati 2, Tiranë, se oferta e paraqitur në vlerën prej: 113,365,021.65 (njëqind e trembëdhjetë milion e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e njetetë e një pike gjashtëdhjetë e pesë) leke (pa TVSH), është identifikuar si oferta e suksesshme, sipas Vendimit të KPP Nr.923/2022 datë 23.09.2022.

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqisni tek Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, me adresë: Blv “Dëshmorët e Kombit” Nd.1, 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Ankesat: ankesa e operatorit ekonomik “REJ” SHPK, datë 15.04.2022 (protokolluar me tonën nr.627 prot., datë 15.04.2022); Vendimin e komisionit të shqyrtimit të ankesave në Organin Qendror Blerës, nr. 627/2 prot., datë 26.04.2022; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 463/2022 datë 16.05.2022. Ankesa e operatorit ekonomik “REJ” SHPK, (protokolluar me tonën nr.1215 prot., datë 25.07.2022); Vendimin e komisionit të shqyrtimit të ankesave në Organin Qendror Blerës, nr. 1215/2 prot., datë 08.08.2022; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 923/2022 datë 23.09.2022.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 04.10.2022.

**TITULLARI I ORGANIT QENDROR BLERËS**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**